

LIGJ
Nr.7595, datë 4.8.1992

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.6943, DATË 26.12.1984 "PËR KODIN RRUGOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 1, "Detyrat e legjislacionit rrugor" ndryshohet si vijon:

"Legjislacioni rrugor i Republikës së Shqipërisë ka për detyrë të mbrojë rrjetin rrugor, si pjesë përbërëse e pronës publike, të sigurojë një qarkullim të pandërprerë e të rregullt për mjetet e transportit rrugor të të gjitha llojeve dhe për këmbësorët, të vendosë një disiplinë të rreptë e të vetëdijshme për punonjësit e transportit dhe personat e tjerë, me qëllim që të parandalohen rreziqet që mund t'i vijnë jetës ose shëndetit të njerëzve, si dhe dëmtimet e pronës shtetërore e private".

Neni 2

Në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë fjalët "Ministria e Punëve të Brendshme; Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë, si dhe prona apo pasuria socialiste" zëvendësohen me fjalët "Ministria e Rendit Publik; Republika e Shqipërisë, prona apo pasuri publike".

Neni 3

Në nenin 38, fjalia e fundit ndryshohet si vijon: "Ndalohet t'u jepen mjetet për drejtim personave të tjerë, kur nuk janë të pajisur me dëshminë e aftësisë përkatëse".

Neni 4

Në nenin 47, mbas paragrafit të parë shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

"Përpara fillimit të përdorimit dhe periodikisht, automjetet e motoçikletat i nënshtrohen procesit të kolaudimit të miratuar nga dikasteret përkatëse, duke u pajisur me dokumentacionin që lejon këtë përdorim".

Neni 5

Neni 55 "Regjistrimi i mjeteve" ndryshohet si vijon:

"Personat fizikë e juridikë që kanë mjete detyrohen t'i regjistrojnë dhe t'i pajisin ato me targë e leje qarkullimi nga organet e qarkullimit rrugor të rrethit ku e ka vendbanimin personi fizik ose qendrën personi juridik, me përjashtim të mjeteve të Ministrisë së Mbrojtjes që i kryen vetë këto veprime".

Kur mjetet kalojnë në pronësi nga një person fizik a juridik te një tjetër, si dorëzuese, ashtu edhe marrësi paraqiten në organet e qarkullimit rrugor për të bërë ndryshimet përkatëse brenda 15 ditëve, pas përfundimit më parë të ndryshimit të aktit të pronësisë.

Automjetet e motoçikletat që janë në pronësi vetiake të shtetasve shqiptarë, dhe ato shtetërore që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, pajisen me targë të përkohshme, me të cilën kanë të drejtë të qarkullojnë 10 ditë nga data e hyrjes në kufirin e Republikës së Shqipërisë.

Për mjetet që dalin përgjithmonë jashtë përdorimit ose ekstradohen përgjithmonë nga vendi

ynë, shtetasit që kërkojnë të lirohen nga detyrimet për këto mjete njoftojnë brenda 10 ditëve organet e kontrollit të qarkullimit rrugor të rrethit përkatës, të cilave ju kthehen njëkohësisht edhe dokumentet përkatëse të njohjes".

Neni 6

Në nenin 61 shtohet pika "c" me këtë përmbajtje:
"Ngarkohet Këshilli i Ministrave të caktojë rregulla të veçanta për drejtuesit e automjeteve që drejtojnë pasagjerë".

Neni 7

Në nenin 63 "Heqja e dëshmisë së aftësisë për një afat të caktuar" bëhen këto ndryshime:
Në shkronjën "a" pika 4 shfuqizohet: shtohet një pikë e re me këtë përmbajtje: "Kur me mjetin që përdor kryen akte rrugaçërie e vagabondazhi, të cilat nuk përbëjnë vepër penale".
Në shkronjën "b" shtohet pika 6 me këtë përmbajtje: "Kur drejtuesi i mjetit nuk zbaton kërkesat e nenit 46 të këtij kodi".
Paragrafi i fundit i nenit 63 ndryshohet si më poshtë:
Dëshmitë e aftësisë hiqen në vend nga organet e qarkullimit rrugor, kur drejtuesit e mjeteve kanë kryer shkelje sipas pikave 1, 2, 4 e 6 të shkronjës "a" dhe pikave 1, 2, 3, 4 e 6 të shkronjës "b", të cilat ia përcjellin menjëherë shefit të qarkullimit rrugor të rrethit".

Neni 8

Neni 70 ndryshohet si më poshtë:
Shkeljet e dispozitave të këtij kodi, të parashikuara në nenet 10-22, 24, 26-43, 44-47, 49-57, 59, 60 e 67, kur nuk formojnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 500 gjer në 5000 lekë nga inspektori i qarkullimit rrugor, akti i të cilit është i formës së prerë.
Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit, te shefi i qarkullimit rrugor, akti i të cilit është i formës prerë.
Kur drejtuesi i mjetit nuk likuidon gjobën brenda 20 ditëve nga data e dhënies, shefi i qarkullimit rrugor të rrethit bllokoi automjetin deri në tre muaj. Nëse gjoba nuk likuidohet brenda këtij afati, organi i rendit publik nxjerr mjetin në ankand për shitje. Nga shuma e fituar mbahet sasia e vlerës së gjobës, duke përfshirë edhe shpenzimet e kryera, dhe diferenca i kthehet pronarit të automjetit.
Për rastet e tjera vjelja e gjobave bëhet sipas rregullave".

Neni 9

Neni 72 ndryshohet si vijon:
"Punonjësit e organeve të kontrollit të qarkullimit rrugor të Ministrisë së Rendit Publik, Ministrisë së Transporteve, Ministrisë së Mbrojtjes dhe Policisë së Rendit, për shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor dhe të mbrojtjes së rrjetit rrugor, kanë të drejtë të gjobisin në vend kundravajtësit me gjobë nga 100 deri në 500 lekë".

Neni 10

Shtohet një nen i ri me këtë përmbajtje:
"Kur një person ia beson për drejtim automjetin një personi të papajisur me patentë, atij i vendoset gjobë në masë 5000 lekë dhe i bllokohet automjeti për tre muaj.
Për zbatimin e këtij neni, veprohet si në nenin 8 të këtij ligji".

Neni 11

Nenet 2, 73, 74 e 75 të kodit rrugor shfuqizohen.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi më datën 15 korrik 1992.

Shpallur me dekretin nr.276, datë 7.8.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha